

Mail federazione.fnai@gmail.com

PEC federazionefnai@pec.it

Facebook: FNAI - Federazione Nazionale delle Associazioni Albanesi in Italia IBAN

IT05S0501801600000016677916 C.F 91378810377

Sito <https://federazionefnai.org/> Sede Via Aldo Moro Nr 13 Cap 63900 Fermo (FM)

KOMUNIKATË

Federata Kombëtare e Shoqatave Shqiptare Itali "FNAI", në bashkëpunim me Shoqatën e Avokatëve Shqiptarë në Itali "AAAI" dhe me shoqata e aktivistë të tjerë, më 19.12.2021 në sallën kryesore të "Villa Fenarolli Palace Hotel" në Brescia (It), me pjesëmarrës prezentë edhe me lidhje online, organizuan konferencën e titulluar "Diaspora dhe Gjuha Shqipe", si një prej faktorëve më të rëndësishëm të ruajtjes së identitetit tonë kombëtar dhe kulturor në Diasporë.

Hapja e punimeve të konferencës me himnin kombëtar shqiptar u pasua me përshëndetjen e presidentes së Federatës "FNAI" dr.Margita Hoxha.

Ajo i bëri një pasqyrim bashkëpunimit me shoqatat pjesëmarrëse në Federatë, bashkëpunorëve të jashtëm e vullnetarëve, të cilët kontribuan në realizimin me sukses të konferencës. Falenderimet për pjesëmarrësit në sallë, bashkëpunëtorët, relatorët, mësuesit si edhe të gjithë bashkëatdhetarët tanë që na ndiqnin nga Kanadaja, Shqipëria, Kosova, Anglia, Greqia, Zvicra, Norvegjia dhe Italia ishin pjesë e vlerësimeve të tyre për mbajtjen e kësaj konference shumë të domosdoshme për situatën që po përjeton gjuha shqipe në Diasporë

Referuesit që morën fjalën ishin:

- **Ndue Shabaku**, mësuesi me përvojë e bashkëthemelues i FNAI-t, solli materialin përgjithësues "Projeksion mbi historinë e gjuhës shqipe".

Av. e Ing. Luljeta Cobanaj, koordinatorë për diasporën pranë Konsullatës së Republikës së Shqipërisë në Milano, prezantoi materialin me temë "Gjuha shqipe dhe integrimi i saj në sistemin arsimor Itali". Në fjalën e saj solli të dhënat dhe statistikat mbi frekuentimin e kurseve dhe shkollave shqipe në Itali. Oratorja përgëzoi organizimet shoqërore e mësuesit për angazhimet, por nga ana tjetër e cilësoi shqetësues për të gjithë faktin se në Itali jetojnë afërsisht 600 mijë shqiptarë ku afro 100 mijë janë nxënës dhe ndërsa vetëm 2% e tyre arrijnë ta mësojnë gjuhën shqipe.

Dr. Mimoza Hysa, drejtore e "Qendrës së Botimeve për Diasporën" në Ministrinë e Jashtëme të Shqipërisë referoi mbi rolin e politikave shtetërore në mbështetjen dhe përhapjen e gjuhës shqipe në diasporë.

Prof. Francesco Altimari, albanolog, docent i gjuhës e letërsisë shqipe dhe të kulturës arbëreshe në Kalabri dhe anëtar i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, solli disa përvoja të teknologjisë dhe metodave të reja në shërbim të gjuhës shqipe dhe asaj arbërishte nga Katedra e Albanologjisë në Universitetin e Kalabrisë.

Av. Gentian Alimadhi, zv.president i Shoqatës së Avokatëve Shqiptarë në Itali dhe ekspert në fushën e të drejtave civile e penale, përcaktoi dy rrugë kryesore, që mund të ndiqen nga ana ligjore për futjen e gjuhës shqipe në shkollat italiane si një gjuhë e zgjedhur. Nga një anë mund të pretendohet rruga më e vështirë, pra kërkesa qeverisë Italiane e interpretimit analogjik apo të zgjeruar të perkufizimit "pakicë gjuhësore historike" e përcaktuar nga ligji 482/99 dhe "karta evropiane e pakicave gjuhësore". Kjo e fundit, edhe pse përjashton nga njëra anë e nocionit të mësipërm gjuhën e emigrantëve, nga ana tjetër, lejon mundësinë e zgjerimit përta përket limitacionit gjeografik apo rajonal që përcakton ligji 482/99.

Ndërsa rrugën e dytë avokati e konsideron më të përshkueshëm dhe të shpejtë me inisiativat në rang lokal për përfshirjen e shkollave të interesuara në bashkëpunim me "uffici scolastici regionali" të cilat do të përcaktojnë bazën didaktike, logjistike dhe burimet financiare. Avokat Alimadhi, përmendi shëmbullin, që kishte ndjekur shteti i Marokut ndërmjet një kosullate të tyre në veri të

Mail federazione.fnai@gmail.com

PEC federazionefnai@pec.it

Facebook: FNAI - Federazione Nazionale delle Associazioni Albanesi in Italia IBAN

IT05S0501801600000016677916 C.F 91378810377

Sito <https://federazionefnai.org/> Sede Via Aldo Moro Nr 13 Cap 63900 Fermo (FM)

Italisë për lidhjen e një marrëveshje me Rajonin e Venetos për disa shkolla të ciklit të ulët që përkujnë me moshat nga 6 deri 12 vjeç në Shqipëri.

Ndër të tjera z. Alimadhi theksoi se, sot është koha për t'u aktivizuar e për të ndjekur të gjitha rrugët e mundëshme parimore e ligjore për mbrojtjen e gjuhës.

Shqipja e kulluar në ligjëratat dhe përsëndetjet e të gjithëve në këtë konferencë ishte një kampion e fortë për prindërit, aktivistët e drejtuesit e organizatave të ndryshme shoqërore, jo vetëm në Itali, por në të gjithë hapësirat mbarë shqiptare. Kjo duhet të përsërijë si një thirrje e fuqishme për kushtrim të gjithë dhe pa hezitim edhe të gjitha partitë tona politike, të cilat janë aktive aty ku flitet gjuha shqipe.

Konferencën e përsëndeti Ambasadorja e Republikës së Shqipërisë në Romë, **dr. Anila Bitri Lami** edhe Konsullja e Përgjithëshme e Rep.së Shqipërisë në Milano, **dr. Anila Pojani** të cilat afruan mbështetjen e tyre në drejtim të bashkëpunimeve për ruajtjen e gjuhës shqipe. Me këtë rast nuk munguan eksperiencat e dashamirësve dhe bashkëpunorëve të Federatës, të cilët në përsëndetjet e tyre e vlerësuan maksimalisht organizimin e kësaj konference, pikërisht nga shoqatat e inkuadruara në Federatën FNAI, si një shembull real, duke dëshmuar me eksperiencat përgjatë viteve në emigracion, se asnjë shoqatë nuk mund të ndërmarrë realizimin e aktiviteteve sensibilizuese dhe në mbrojtje të interesave të komunitetit shqiptar në Itali e vetme e në veçanti **për mbrojtjen e gjuhës shqipe**.

Konkretisht në programin e Federatës Kombëtare Shqiptare për organizimin e Konferencës u kërkua bashkëpunim i gjerë.

Thirrjes për bashkëpunim iu përgjigj **"Shoqata e Avokatëve Shqiptarë në Itali"** me **president z. Arjol Kondi**. U ra dakort edhe për temat që do të trajtoheshin e si do të sillnin opinionin e tyre në bazë të eksperiencave dhe ligjeve në fuqi.

Me keqardhje, shprehim keqardhjen, që nuk u arrit bashkëpunimi me Lidhjen e Mësuesve në Itali me përfaqësuesit e saj ???!

Konferencën e përsëndeti edhe "Ambasadore e Kombit" dhe "Presidente Nderi" e bashkësisë shqiptare në Kanada, **dr. Ruki Kondaj** e cila falenderoi organizatorët e kësaj Konference për ftesën dhe vlerësoi inisiativën për të ngulmuar tek mësimi gjuhës sonë. "Dihet që kombet dallohen nga gjuha dhe flamuri i tyre kombëtar dhe për ju është aq e rëndësishme që keni zgjedhur këtë temë për të cilën me anë të kësaj Konference do të kërkoni zyrtarizimin e gjuhës shqipe në Itali shtoi zj.Ruki Kondaj.

Nga komuniteti shqiptar në Norvegji, përsëndeti presidenti i shoqatës lobiste shqiptare dhe drejtor i shkollës shqipe "Albnor Rogaland" **z. Fehmi Bekteshi**, i cili informoi se shoqatat shqiptare në Norvegji i kanë kërkuar parlamentit Norvegjez, futjen e gjuhës shqipe në programin e tyre arsimor. Ai u bëri apel të gjithë prindërve shqiptar që t'u flasin shqip fëmijëve të tyre.

Nga Greqia **znj. Brikena Qama**, si Presidente e Organizatës Mbarëkombëtare Shqiptare Lobiste "LEASH" shpjegoi inisiativën e konkursit që ata organizuan për fëmijët e disa shkollave shqipe në Diasporë së bashku me disa shoqata të tjera në Shqipëri, Kosovë, Zvicër, Angli, Norvegji dhe Greqi. Ndër të tjerat ajo u shpreh për të njejtat shqetësime që ka komuniteti shqiptar në Greqi për sa i përket zyrtarizimit të gjuhës shqipe.

Mësuesja e gjuhës shqipe **Anila Kadija**, përsëndeti dhe përgëzoi organizatorët për këtë Konferencë. Ajo shtoi se suksesi i ecjes përpara në misionin fisnik të mësuesit qëndron tek bashkëpunimi, duke lënë mënjane egon personale dhe duke lidhur shkollën me rregullat e ligjet ...



Mail federazione.fnai@gmail.com

PEC federazionefnai@pec.it

Facebook: FNAI - Federazione Nazionale delle Associazioni Albanesi in Italia IBAN

IT05S0501801600000016677916 C.F 91378810377

Sito <https://federazionefnai.org/> Sede Via Aldo Moro Nr 13 Cap 63900 Fermo (FM)

Mësues,aktivistë e drejtues të shoqatave të ndryshme nga Lecco, Trieste, Ferrara, Pordenone, Belluno, Treviso, Trento, Padova, Bergamo, Brescia, Parma, Milano, Chiari, Marche, etj, edhe pse në kushte jo të favorëshme të pandemisë me pjesëmarrjen e tyre demonstruan vlerësimin më të lartë për konferencën.

Mbas konferencës u vazhdua me drekën tradicionale të fundvitit në të cilën u vlerësuan me **Fletë Nderi** dhe **Çertifikata Mirënjohjeje** disa individë, shoqata dhe shkolla për veprimtaritë e tyre në fushën e trashëgimisë kulturore dhe të gjuhës shqipe. Njëkohësisht pati vlerësime edhe për bashkëthemeluesit e Federatës Kombëtare Shqiptare FNAI.

Këshilli i Përgjithshëm i FNAI-it.

19.12.2021